



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2019

SESIONI I – ME ZGJEDHJE

SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: FILOZOFI-SOCIOLOGJI

VARIANTI B

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1 B 1 pikë

Pyetja 2 D 1 pikë

Pyetja 3 D 1 pikë

Pyetja 4 B 1 pikë

Pyetja 5 B 1 pikë

Pyetja 6 A 1 pikë

Pyetja 7 A 1 pikë

Pyetja 8 D 1 pikë

Pyetja 9 B 1 pikë

Pyetja 10 B 1 pikë

Pyetja 11 2 pikë

Model përgjigjeje

Normat kulturore	Normat ligjore
<ul style="list-style-type: none">kanë lindur më herët në histori, për të rregulluar marrëdhëniet mes individëve;vendosen nga shoqëria;kanë fushë më të gjerë veprimi;janë më të shumëllojshme se normat ligjore;ndryshojnë më ngadalë në kohë, sepse mentaliteti i njerëzve përfaqëson bindjet e njerëzve që janë të qëndrueshme;	<ul style="list-style-type: none">lindën më vonë në histori, pra me lindjen e shtetit;vendosen nga organet kompetente, organi më i lartë ligjvënës është parlamenti;kanë fushë më të kufizuar veprimi sesa normat kulturore, ato hyjnë në veprim në rastet kur shkeljet e normave kulturore janë të rënda;janë më pak të shumëllojshme se normat kulturore;ndryshojnë më shpejt se sa normat kulturore, në përputhje me nevojat e shoqërisë;

<ul style="list-style-type: none"> • shoqërohen me reagime të opinionit shoqëror; • zbatohen me dëshirën e gjithësecilit; 	<ul style="list-style-type: none"> • shoqërohen me sanksione ligjore ose dënime për ata që nuk respektojnë rregullat e pranuar nga shumica; • zbatohen me detyrim, me forcën shtrënguese të shtetit dhe janë të barabarta për të gjithë etj
---	---

2 pikë	nëse eidenton dy dallime mes normave kulturore dhe normave ligjore;
1 pikë	nëse eidenton një dallim mes normave kulturore dhe normave ligjore;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Aftësimi intelektual dhe profesional – / nxënësit marrin njohuri në shkencë të ndryshme ekzakte dhe shoqërore, si matematikë, kimi, gjuhë, letërsi, histori etj., duke i aftësuar ata intelektualisht dhe profesionalisht; / I përgatit dhe i aftëson për tregun e punës; / U jep informacion, dije, kulturë, të nevojshme për t'u përshtatur në shoqërinë ku jetojnë etj.
- Zgjerimi i ndërveprimit me të tjerët –/ zgjeron rrethin shoqëror mes racave, nënkulturave, gjinive, besimeve dhe bindjeve të ndryshme.
- Programi mësimor i fshehtë – / kultivimi dhe zhvillimi i talenteve, prirjeve, pasioneve në fusha të ndryshme si arti, sporti etj.
- Stimulimi dhe motivimi i shpirtit konkurrues dhe ambicies për të qenë të suksesshëm etj.
- Edukimi -/ me rregulla dhe norma të sjelljes dhe bashkëveprimit me të tjerët; përcaktimi i kufijve të sjelljes normale brenda grupit shoqëror;/ përcaktimi i sanksioneve ose dënimeve në raste të shkeljes së kriterëve të sjelljes apo normave etj.

3 pikë	nëse tregon tri funksione të shkollës lidhur me shoqërizimin;
2 pikë	nëse tregon dy funksione të shkollës lidhur me shoqërizimin;
1 pikë	nëse tregon një funksion të shkollës lidhur me shoqërizimin;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**2 pikë****Model përgjigjeje**

- Përcaktimi i kufijve morale - rregullat në shoqëri përcaktojnë kufijtë moralë të sjelljeve, që i detyrojnë njerëzit të sillen brenda tyre. / Sjelljet deviante janë shkelja ose kapërcimi i kufijve të vendosura nga shoqëria, pra kur sjellja e individit, grupit etj., bëhet shqetësim për të tjerët ose shkel të drejtat e tyre. / Ndaj sjelljeve deviante që shkelin "kufijtë e të moralshmes" reagon shoqëria, por shpesh edhe ligjet. / Reagimet kundërshtuese të opinionit ose ligjeve ndaj shkeljes së kufijve moralë shërbejnë për të mirën e shoqërisë, sepse u mësojnë të tjerëve si të sillen brenda normave shoqërore.
- Forcimi i unitetit shoqëror - shumica e njerëzve përjetojnë ndjenjën e zemërimit ndaj atyre që shkelin normat dhe rregullat e vendosura nga shoqëria, veçanërisht ndaj krimeve. Kjo i bën njerëzit më të vetëdijshëm për vlerat dhe normat që i bashkojnë. / Për t'u mbrojtur nga sjelljet deviante njerëzit forcojnë unitetin mes tyre.

2 pikë	nëse shpjegon përkatësisht funksionin a) dhe b);
1 pikë	nëse shpjegon përkatësisht funksionin a) ose b);
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Pavarësia ekonomike e grave. / Punësimi i grave.
- Rritja e nivelit të arsimit dhe e personalitetit të grave. / Gratë e arsimuara, të emancipuara dhe me personalitet, nënshtrohen më pak ndaj dhunës fizike, psikologjike, emocionale, ekonomike, etj. të

bashkëshortëve. / Psh vajzat me arsim të lartë, që kanë liri ekonomike, intelektuale dhe emocionale, përzgjedhin bashkëshortin, kanë më shumë kërkesa ndaj jetës dhe nuk i nënshtrohen dhunës.

- Ndryshimet në statuset e bashkëshortëve / Ndryshimet gjatë jetës të statuseve të njeriut ose të të dy bashkëshortëve (pasurimi, karriera në profesion etj).
- Jetesa më e individualizuar. / Përkushtimi ndaj profesioneve private si mjekët, artistët, juristët, bizneset private etj., bën që njerëzit të jenë më të lire, të kalojnë më pak kohë pranë familjes dhe për pasojë të shtyhen drejt divorceve.

3 pikë nëse identifikon tri faktorë të rritjes së numrit të divorceve;

2 pikë nëse identifikon dy faktorë të rritjes së numrit të divorceve;

1 pikë nëse identifikon një faktor të rritjes së numrit të divorceve;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15

2 pikë

Model përgjigjeje

Forma të shfaqjes së paragjyqimeve janë:

- Stereotipat – përcaktohen si përshkrime të kategorive të ndryshme të njerëzve, të cilat vazhdojnë edhe përballë fakteve që i kundërshtojnë. / Stereotipat paragjyqes mund të jenë me natyrë racore, etnike, kombëtare etj.
- Racizmi – besimi se racat kanë më shumë ose më pak përparësi apo mangësi gjenetike në krahasim me njëra – tjetrën. / Këto besime janë të paprovuara shkencërisht.

2 pikë nëse përshkruan dy forma të shfaqjes së paragjyqimeve në shoqëri;

1 pikë nëse përshkruan një formë të shfaqjes së paragjyqimeve në shoqëri;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16

3 pikë

Model përgjigjeje:

- a) Përcaktimi i kuptimit të jetës - besimet fetare ndikojnë në drejtpeshimin psikologjik të njerëzve, i ngushëllojnë dhe i vetëdijësojnë ata për të përballuar dhimbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë ose vështirësitë e jetës së përditshme.
- b) Forcimi i unitetit shoqëror - Feja ndikon në forcimin e unitetit të anëtarëve të shoqërisë nëpërmjet predikimit dhe kontrollit të zbatimit të vlerave dhe normave të njëjta.
- c) Faktor i kontrollit shoqëror - përmes mistifikimit, besimet fetare i detyrojnë njerëzit të zbatojnë me korrektësi normat kulturore, sidomos ato më jetike për funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë.

3 pikë nëse shpjegon përkatësisht funksionet a), b) dhe c);

2 pikë nëse shpjegon përkatësisht dy prej funksioneve a), b) dhe c);

1 pikë nëse shpjegon përkatësisht një prej funksioneve a), b) dhe c);

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17

3 pikë

Model përgjigjeje:

1. **Papunësia:** për shkak të: modernizimit të prodhimit dhe pajisjeve teknike që zëvendësojnë punën e krahut të punëtorëve; / mungesës së shkollimit të duhur; / mungesës së përvojës ose kualifikimit të nevojshëm; / të moshës (në moshë shumë të re 16-19 ose në moshë të shtyrë); / të gjinisë, përgjithësisht është më e lartë tek gratë sesa tek burrat, për shkak të detyrimeve familjare ose paragjyqimeve gjinore; / migrimit dhe emigrimit (lëvizja nga një vend në tjetrin sjell papunësinë deri në një stabilizim të ri); / shtimit të popullsisë në qendrat e zhvilluara urbane, për pasojë mungesës së vendeve të punës etj.
2. **Ekonomia e paligjshme:** ka shumë bizneseve dhe veprimtari ekonomike të përgjithshme dhe që nuk paguajnë taksë ndaj shtetit. Kjo ndodh për shkak të punës së pasiguar të punonjësve, sepse:
 - pronarët kanë interes të deklarojnë më pak të ardhura dhe të paguajnë më pak taksë ndaj shtetit;
 - të punësuarit kanë interes të marrin më shumë para (pa ju mbajtur pjesa e kontributeve), si psh të rinjtë, nevojtarët, të dypunësuarit etj.;

- ndalimi me ligj i dypunësimit, i detyron njerëzit të mos deklarojnë punën e dytë;
- të punësuarit nuk kanë mundësi tjetër zgjedhje (detyrohen, për shkak të papunësisë), si p.sh punëtorët e krahut që punojnë me orë ose ditë pune;
- të punësuarit nuk sigurohen dot për shkak të moshës, si p.sh të miturit, nën moshën 18 vjeç.

3. **Rritja e peshës specifike të punëve “jakëbardha”** ose të punësuarit në sektorin e punës mendore dhe të shërbimeve, për shkak të rritjes së:

- kërkesave të njerëzve për shërbime, për një jetë sa më cilësore dhe me lehtësira. Kjo çon në rritjen e numrit të sektorëve të shërbimeve, si psh në arsim, shëndetësi, banka, tregti, transport, shërbime telefonike, hidrosanitare, turizëm, administratë publike shtetërore ose private etj.
- kërkesave të njerëzve për punësim në këto sektorë, për shkak të: rritjes së numrit të atyre që mbarojnë studimet në këto sektorë; preferencave për sektorët e shërbimit, që nuk kanë shumë lodhje fizike ose mendore, prandaj kryhen lehtësisht nga të gjithë, pa përjashtuar të rinjtë dhe gratë; fitohet mirë; kanë variacion pasi kanë kontakte me njerëzit dhe mundësojnë njohje të shumta; ofrojnë mundësi për të bërë karrierë etj.

- 3 pikë** nëse shpjegon përkatësisht karakteristikat a), b) dhe c);
2 pikë nëse shpjegon përkatësisht dy prej karakteristikave a), b) dhe c);
1 pikë nëse shpjegon përkatësisht një prej karakteristikave a), b) dhe c);
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

Lëvizja feministe ka këto objektiva:

- zbutjen e pabarazisë gjinore: Ndryshimi i mendësive ose mentalitetit të shoqërisë, mbi dallimet gjinore, si modele të reja sjelljeje, mendimi dhe veprimi, që i shikojnë burrat dhe gratë të barabartë në të drejta.
- përmirësimin e legjislacionit përkatës: për mbrojtjen e grave nga dhuna, diskriminimi.
- ndryshimin e politikave për punësimin dhe aktivizimin e grave në fusha të ndryshme të jetës.
- përkrahja e lirisë seksuale: gratë të vendosin kontrollin mbi seksualitetin dhe riprodhimin, si psh. për martesën, lindjen e fëmijëve ose ndërprerjen e shtatzanisë.

- 2 pikë** nëse identifikon dy prej objektivave të lëvizjes feministe;
1 pikë nëse identifikon një prej objektivave të lëvizjes feministe;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **B** **1 pikë**

Pyetja 20 **A** **1 pikë**

Pyetja 21 **B** **1 pikë**

Pyetja 22 **D** **1 pikë**

Pyetja 23 **C** **1 pikë**

Pyetja 24 **C** **1 pikë**

Pyetja 25 **B** **1 pikë**

Pyetja 26 **D** **1 pikë**

Pyetja 27 **C** **1 pikë**

Pyetja 28 **C** **1 pikë**

Pyetja 29

2 pikë

Model përgjigjeje

a) **njohjen e vetvetes:** Sipas Sokratit njohja e vetes, e natyrës njerëzore është shumë e rëndësishme, sepse duke njohur shpirtin tonë mësojmë për:

- padijen, dobësitë, dhe iluzionet tona;
- atë çfarë e bën shpirtin tonë të lumtur, pra çfarë veprimesh i sjellin atij lumtur. / Njohja e vërtetë e shpirtit është baza e një jete të lumtur dhe të moralshme. / Njohja fillon nga vetja, tek thellimi dhe kthimi ndaj vetes, ku ndodhen të gjitha përgjigjet e pyetjeve tona. Ne thjesht duhet t'i zbulojmë ato brenda nesh.

b) **rrugën drejt lumturisë:** lumturia, sipas tij, është mirëqenia e shpirtit; çdokush ka dëshirë të jetë i lumtur. Si arrihet lumturia:

- **Dija** mbi shpirtin të çon drejt virtutit dhe lumturisë. / Për të patur një shpirt të lumtur duhet të dish dallimin mes të mirës dhe të keqes, vesit dhe virtutit. / Dija mbi to, na ndihmon të zbulojmë dobësitë dhe padijen tonë, të cilat na largojnë nga rruga e lumturisë dhe na çojnë drejt iluzioneve dhe veprimeve të gabuara. / Dituria është virtyt, ndërsa ligësia është mungesa e dijes, injoranca. / **Padija** i shtyn njerëzit të bëjnë sjellje dhe veprime të gabuara në jetë, si psh: pushteti, pasuria etj.
- **Kujdesi ndaj shpirtit**, që ai të jetë i lumtur, është shqyrtimi i vazhdueshëm i jetës, në çdo hap që hedh, për të njohur gabimet dhe për t'i përmirësuar ato. Një jetë me virtyt çon drejt lumturisë. Bërja e shpirtit sa më të mirë që të ishte e mundur çdo ditë.
- **Filozofia**, që ka si detyrë kryesore të kuptuarit e vetes dhe arritjen e lumturisë. / Sokrati mendonte se filozofët, si njerëzit më të ditur, janë në gjendje t'i japin shpjegim të keqes dhe të gjejnë rrugën e lumturisë së shpirtit për çdo individ.

2 pikë nëse shpjegon **a) edhe b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me to;

1 pikë nëse shpjegon **a) ose b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me to;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30

3 pikë

Modele përgjigjeje

Rrugët që të çojnë drejt lumturisë, sipas Epikurit, janë:

- çlirimi i njeriut nga frika e perëndive;
- çlirimi i njeriut nga frika e vdekjes;
- pushimi, ekuilibrimi dhe shmangia e dhimbjeve të trupit;
- paqja dhe qetësia e shpirtit, duke larguar shqetësimet e panevojshme;
- mençuria dhe dija e njeriut;
- respektimi i parimeve që na mëson filozofia;
- plotësimi i kërkesave të natyrës njerëzore (ushqimi, pushimi i trupit dhe mendjes dhe kënaqësi të tjera të trupit);
- mostejkalimi i kufijve të dëshirave dhe kontrolli i tyre përmes mendjes;
- vënia e interesit shoqëror në shërbim të individit;
- përmbushja e dëshirave në të tashmen, pa u shqetësuar për të shkuarën dhe të ardhmen.

3 pikë nëse identifikon tri nga rrugët e mësipërme;

2 pikë nëse identifikon dy nga rrugët e mësipërme;

1 pikë nëse identifikon një nga rrugët e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31

3 pikë

Model përgjigjeje

- Burimi i lëvizjes: në natyrë gjenden gjëra në lëvizje dhe të tjerat në qetësi, por që mbartin në vetvete mundësinë e lëvizjes. Shkaku fillestar është në gjendje të vërë në lëvizje trupat, pa qenë vetë në lëvizje dhe ky mund të jetë vetëm Zoti.

- Shkaku dhe pasoja: sendet dhe fenomenet nuk ekzistojnë dhe nuk ndodhin pa një shkak të caktuar, por zinxhiri shkak-pasojë është i pafundëm. Shkaku i parë duhet të jetë ndryshe nga qeniet tokësore që kanë një shkak paraardhës. Kjo fuqi është Zoti.
- Rregulli universal: në natyrë ekziston një rregullsi perfekte, si lindja dhe perëndimi i diellit, etj. M.q.s këtu nuk mund të flitet për planifikim të arsyeshëm dhe as për rastësi, atëherë duhet të ekzistojë një inteligjencë universale që planifikon gjithçka dhe vendos rregull. Kjo forcë mund të jetë vetëm Zoti.

3 pikë	nëse shpjegon tri provat e mësipërme;
2 pikë	nëse shpjegon dy nga provat e mësipërme;
1 pikë	nëse shpjegon një nga provat e mësipërme;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **2 pikë**
Model përgjigjeje

Sipas Dekartit:

- **Momenti i dyshimit**: Ne jemi qenie të papërsosura, që mund të mashtrohemi lehtë, për pasojë duhet të dyshojmë për çdo gjë dhe në çdo çast, deri edhe në ekzistencën tonë. “A ekzistoj unë?” – pyet Dekarti.
- **Momenti i sigurisë**: bindja që ne ekzistojmë vjen nga fakti se ne mendojmë. Gjithsecili nga ne mund të thotë me bindje se ekziston. Në çastin që është duke menduar këtë gjë, është e qartë se ky pohim është i vërtetë. Pra, siguria e parë dhe mbështetëse për ekzistencën tonë, për të kaluar nga dyshimi tek e vërteta, sipas Dekartit, është vetë procesi i të menduarit apo të dyshuarit. “Mendoj, pra ekzistoj” – përgjigjet Dekarti.

2 pikë	nëse shpjegon dy momentet e mësipërme;
1 pikë	nëse shpjegon një nga momentet e mësipërme;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33 **3 pikë**
Model përgjigjeje

Sipas Rusoit shteti lindi si marrëveshje mes njerëzve ose si një kontratë shoqërore kushtëzuar nga nevoja:

- për të mbrojtur: - jetën, nga sjellja agresive ndaj njëri – tjetrit;
- për të mbrojtur - paqen, dhe harmoninë mes njerëzve
- për të mbrojtur - pronën private, të cilën Rusoi e quan shkaktare të pabarazisë shoqërore dhe ndarjes në klasa të pasura dhe të varfra;
- për të mbrojtur - rregullin dhe drejtësinë, përmes ligjeve dhe ushtrimit të forcës dhe dhunës mbi ata që nuk i binden vullnetit të shumicës;
- për të mbrojtur - barazinë e të drejtave të individëve.
- për të arritur të mirën e përbashkët;
- për të garantuar një shoqëri më të mirë, një shtet demokratik, që siguron barazinë para ligjit të qytetarëve;
- për të ushtruar pushtetin e popullit sovran, ku gjithçka vendoset me votën e qytetarëve.

3 pikë	nëse identifikon tre nga faktorët;
2 pikë	nëse identifikon dy nga faktorët;
1 pikë	nëse identifikon një nga faktorët;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 34 **2 pikë**
Model përgjigjeje

- **Mbinjeriu** – Niçe e mohonte konceptin e barazisë, sepse sipas tij, vlerat morale janë të ndryshme tek çdo individ, nuk mund të ketë të mirë të përgjithshme. Historia, sipas Niçes, ecën drejt krijimit të mbinjeriut, pra të një individi:
 - të jashtëzakonshëm, që tejkalon çdo ditë vetveten, duke zbuluar një vete të re, përtej asaj që është. Këta individë janë vërtet pak, por iu takon e ardhmja e evolucionit historik;
 - të lartë, me vlera të rralla, që guxon të rivlerësojë vlerat ekzistuese të shoqërisë;
 - me nivelin më të lartë të zhvillimit të fuqisë fizike, intelektuale dhe emocionale;
 - vërtetë të lirë, të cilin nuk e ndalon asgjë;
 - ideal, tek i cili ekuilibrohen intelektin, racionalitetin dhe pasionin dhe energjinë;
 - i fortë që lufton dhe fiton ndaj vetvetes, duke u përballur me rreziqet;
 - kapërcen realitetin faktik dhe kufizimet e tij.
- **Vullneti për pushtet** – Për të krijuar “mbinjeriun” është i nevojshëm “vullneti për pushtet”, që Niçe e shikon si:
 - një fuqi të brendshme të njeriut, një shtytje e brendshme për të tejkaluar të mirën dhe të keqen;
 - fuqi krijuese, që është e aftë të formojë dhe krijojë ngjarje;
 - shprehje e fuqisë natyrore të njeriut, për të nxjerr në pah forcën dhe për të ushtruar pushtet;
 - fuqi që shfaq vetveten kudo dhe në çdo gjë;
 - fuqi që nuk e gëzojnë të gjithë në masë të njëjtë. Për këtë arsye, njerëzit nuk mund të jenë të barabartë.
 - përpjekje për rritjen dhe ushtrimin e pushtetit, me qëllim kapërcimin e pengesave dhe të keqes në jetë; Por, këtë vullnet njeriut ia kanë shtypur kisha dhe dogmat e saj, si dhe shoqëria me sistemin e vlerave.
 - fitore mbi vetveten, pra si kapërcim i vështirësive;
 - gëzim, kënaqësi, që vjen nga ndjenja e fuqizimit të pushtetit.

2 pikë	nëse shpjegon dy çështjet e mësipërme;
1 pikë	nëse shpjegon një nga çështjet e mësipërme;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 35**3 pikë****Model përgjigjeje**

Sipas Sartrit si ekzistencialist:

- vullneti njerëzor nuk varet nga forca hyjnore, ai është i lirë; njeriu është i plotfuqishëm për të vendosur për jetën dhe nuk ka nevojë për një forcë tjetër, që të vendosë. Pa Zotin gjithçka është e mundur. Ai nuk ekziston, sepse nuk mund të ekzistojë asnjë qenie e përsosur. Kjo është liria për Sartrin.
- nuk ka qëllim të paracaktuar në ekzistencën tonë, pra fati nuk është i përcaktuar, çdo njeri vendos për veprimet e veta. Njeriu mund të ndryshojë veten, në bazë të zgjedhjeve të lira; asgjë nuk na pengon të ndërmarim veprimet që duam, të bëjmë atë që duam në jetë, duke ndërtuar jetën që dëshirojmë.
- Sartri pranon edhe se liria kufizohet nga gjykimi i të tjerëve, sepse ne nuk jemi qenie të vetmuara, por individë shoqërorë; Sartri pranon rolin e shoqërisë mbi ne, ne nuk jemi të shkëputura prej saj dhe gjykimeve të të tjerëve, kjo na krijon një ankth të vazhdueshëm. Por, në fund të fundit, individë e zgjedh vetë rrugën e tij drejt lirisë, duke qenë i përgjegjshëm për rëndësinë e zgjedhjeve të tij në jetë, për vete dhe për të tjerët.
- Çdo gjë që bëjmë zbulon se çfarë mendojmë se duhet të jemi, çdo zgjedhje që bëjmë na përcakton si individë dhe kjo barrë e përgjegjësisë, që njeriu i lirë duhet të mbajë, i shkakton atij, po ashtu, një ankth të vazhdueshëm. Ne jemi vetë përgjegjës për kufizimin e lirisë tonë, sepse jeta na i jep të gjitha mundësitë. Duhet ta pranojmë lirinë tonë dhe ta jetojmë jetën ashtu siç dëshirojmë.

- Gjërat materiale dhe paraja, sipas tij, e kufizojnë lirinë e njeriut, sepse nevoja për para është justifikimi i njerëzve për të kufizuar lirinë e tyre. Domosdoshmëria për gjëra materiale nuk ekziston në realitet, ajo është një konstruksion shoqëror, që nxit njerëzit të mohojnë lirinë e tyre.

3 pikë	nëse analizon lirinë duke evidentuar tri nga aspektet e mësipërme;
2 pikë	nëse analizon lirinë duke evidentuar dy nga aspektet e mësipërme;
1 pikë	nëse analizon lirinë duke evidentuar një nga aspektet e mësipërme;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 36**2 pikë****Model përgjigjeje:****Sipas Marksit:**

- Feja lindi nga injoranca dhe padija e njerëzve primitivë, në pamundësi për të shpjeguar fenomenet e botës që i rrethonte.
- Feja vazhdon të ekzistojë për shkak të rrethanave të palumtura dhe vështirësive ekonomike të njerëzve në sistemin kapitalist, të cilët nuk gjejnë rrugëdalje tjetër nga realiteti i tyre.

Feja, sipas Marksit, është si opium, që nuk e lejon popullin:

- të ketë një ndërgjegje të saktë për botën, duke i ofruar atij një botë iluzionesh;
- të kuptojë padrejtësitë që i bëhen, duke e vënë në gjumë;
- të ngrihet kundër padrejtësive dhe shtypjes, për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë.

2 pikë	nëse identifikon dy aspekte të filozofisë ateiste të Marksit;
1 pikë	nëse identifikon një aspekt të filozofisë ateiste të Marksit;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.